Fitimet (Humbjet) e mbajtura	5	(25,828,470)	(26,044,157)
Rezervat e tjera-fitimi I vitit	5	(5,370,713)	215,687
Gjithsej ekuiteti		326,696,303	335,384,450
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		365,219,089	369,612,791

Tabel 2. 3. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

Pasqyra e ndryshimit në Ekuitet				
	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2022	190,215,350	(26,044,157)		164,171,193
Fitimi / (humbja) i/e vitit	0	215,687	0	215,687
Diferencat nga përkthimet valutore	0	0	0	0
Dividendat	0	0	0	0
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	170,997,569	0	0	170,997,569
Ndarja e rezervave	0	0	0	0
Gjendja më 31 dhjetor 2022	361,212,919	(25,828,470)		335,384,449
Gjendja më 1 janar 2023	361,212,919	(25,828,470)		335,384,449
Fitimi / (humbja) i/e vitit	0	(5,370,713)	0	(5,370,713)
Diferencat nga përkthimet valutore	0	0	0	0
Dividendat	0	0	0	0
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	(3,317,432)		0	(3,317,432)
Ndarja e rezervave	0	0		0
Gjendja më 31 dhjetor 2023	357,895,487	(31,199,183)	0	326,696,303

Tabel 2. 4. Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

Pasqyra e rrjedhjes së parasë e konsoliduar për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023			
	Shënimi	2023	2022
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) para tatimit		(5,370,713)	215,687
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	1	1,361,298	1,371,317
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		0	0
Amortizimi i pasurive të paprekshme		0	0
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		0	0
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese		0	0
Të ardhurat financiare	7		100,717
Shpenzimet financiare	9.3	0	0
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	7.1	0	0
Shpenzimet e tatimit në fitim	10	0	0
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		(4,009,415)	1,687,721
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3	-1,263,641	(682,451)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	4	(2,226,040)	1,665,762
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	3.1	(691,615)	(958,293)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	6.2	2,534,224	1,137,566
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	6	(247,119)	225,967
Tatimi në fitim i paguar	10	0	0
Interesi i paguar	9.3	0	0
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		(5,903,607)	3,076,272
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	1	(917,721.55)	(986,352)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7.1	162,839	
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		0	0
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		0	0
Interesi i arkëtuar		0	0
Dividendat e arkëtuara		0	0
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(754,883)	(986,352)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë	5	6,356,884	(3,004,472)
Dividendat e paguara		0	0
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	6	0	0
Ripagimi i kredive dhe huave	6	0	0
Pagesat e lizingut financiar		203,689	304,507
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		6,560,573	(2,699,965)
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		-97,916	(610,045)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	2	397,673	1,007,718
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		299,757	397,673

3. Progresi me planin e biznesit

3.1. Pasqyrë e progresit në implementimin e planit të biznesit

Viti 2023 ka qenë një nga vitet më të vështira për sa i përket furnizimeve me lëndë të parë për eksploatim e poashtu edhe për pasurim të mineralit për shkak të çrregullimit (ngritjes së çmimeve) të çmimeve si shkak i inflacionit. Edhe përkundër të gjitha vështirësive është arritë të mbahet kontinuiteti i prodhimit të koncentrateve në Flotacionin Tuneli i Parë dhe Flotacionin në Kishnicë.

Tabel 3. 1. Progresi i prodhimit të koncentratit të plumbit 2023

Koncentrati i Pb	Planifikimi 2023 në (t)				Realizimin 2023 në (%)				Krahasimi i Planifikimit me Realizimin në (%)
	Flotacioni në Tunelin e Parë	Flotacioni në Kishnicë	Flotacioni në Lepasaviq	Gjithsejt	Flotacioni në Tunelin e Parë	Flotacioni në Kishnicë	Flotacioni në Lepasaviq	Gjithsejt	
Janar	511.00	0.00	695.00	1,206.00	304.00	50.00	237.00	591.00	49.00%
Shkurt	540.14	0.00	695.00	1,235.14	445.00	24.00	320.00	789.00	63.88%
Mars	518.50	125.00	695.00	1,338.50	750.00	47.90	279.00	1,076.90	80.46%
Prill	483.80	125.00	695.00	1,303.80	500.00	33.75	340.00	873.75	67.02%
Maj	545.46	125.00	695.00	1,365.46	455.00	75.13	241.00	771.13	56.47%
Qershor	538.65	125.00	695.00	1,358.65	282.00	45.00	208.00	535.00	39.38%
Korrik	644.62	75.00	698.00	1,417.62	220.00	32.00	327.00	579.00	40.84%
Gusht	628.09	65.00	698.00	1,391.09	245.00	50.00	320.00	615.00	44.21%
Shtator	731.58	110.00	698.00	1,539.58	206.00	46.00	329.00	581.00	37.74%
Tetor	578.76	123.00	702.00	1,403.76	140.00	35.70	263.00	438.70	31.25%
Nëntor	658.80	130.00	702.00	1,490.80	135.00	25.10	250.00	410.10	27.51%
Dhjetor	643.93	97.00	702.00	1,442.93	75.00	45.00	134.00	254.00	17.60%
Gjithsejt	7,023.33	1,100.00	8,370.00	16,493.33	3,757.00	509.58	3,248.00	7,514.58	45.56%

Plani i prodhimit të koncentratit të Pb për vitit 2023, nga tri njësitë biznesore Miniera me Flotacion Stan Tërg, Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë dhe Minierat e Kopaonikut me flotacion në Lepasaviq, krahasuar me planin e biznesit është realizuar 45.56 %.

Tabel 3. 2. Progresi i prodhimit të koncentratit të zinkut 2023

Koncentrati i Zn	Planifikimi 2023 në (t)				Realizimin 2023 në (%)				Krahasimi i Planifikimit me Realizimin në (%)
Muaji	Flotacioni në Tunelin e Parë	Flotacioni në Kishnicë	Flotacioni në Lepasaviq	Gjithsejt	Flotacioni në Tunelin e Parë	Flotacioni në Kishnicë	Flotacioni në Lepasaviq	Gjithsejt	
Janar	750.21	0.00	695.00	1,445.21	230.00	83.00	455.00	768.00	53.14%
Shkurt	791.85	0.00	695.00	1,486.85	385.00	47.00	459.00	891.00	59.93%
Mars	640.38	200.00	695.00	1,535.38	628.00	101.00	561.00	1,290.00	84.02%
Prill	604.84	200.00	695.00	1,499.84	300.00	51.45	419.00	770.45	51.37%
Maj	717.84	200.00	695.00	1,612.84	285.00	90.11	349.00	724.11	44.90%
Qershor	708.87	200.00	695.00	1,603.87	380.00	83.00	480.00	943.00	58.80%
Korrik	600.81	138.00	698.00	1,436.81	202.00	53.00	443.00	698.00	48.58%
Gusht	622.11	139.00	698.00	1,459.11	324.00	65.00	398.00	787.00	53.94%
Shtator	719.34	156.00	698.00	1,573.34	257.00	68.00	348.00	673.00	42.78%
Tetor	750.17	154.00	702.00	1,606.17	221.00	55.00	271.00	547.00	34.06%
Nëntor	791.43	155.00	702.00	1,648.43	160.00	45.00	387.00	592.00	35.91%
Dhjetor	751.06	158.00	702.00	1,611.06	175.00	58.00	195.00	428.00	26.57%
Gjithsejt	8,448.91	1,700.00	8,370.00	18,518.91	3,547.00	799.56	4,765.00	9,111.56	49.20%

Plani i prodhimit të koncentratit të Zn për vitit 2023, nga tri njësitë biznesore Miniera me Flotacion Stan Tërg, Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë dhe Minierat e Kopaonikut me flotacion në Lepasaviq, krahasuar me planin e biznesit është realizuar 49.20 %.

Tabel 3. 3. Prodhimi i koncentratit të Pb dhe Zn në vitin 2023 për tri Njësitë Biznesore; Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg, Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë dhe Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Kopaonik-Lepasaviq

Realizimi 2023				
Muaji	Stan Tërg - Tuneli I Parë	Artanë - Kishnicë	Kopaonik-Lepasaviq Pb+Zn(t)	Gjithsejt ton
	Koncentrat Pb dhe Zn në (t)	Koncentrat Pb dhe Zn në (t)	Koncentrat Pb dhe Zn në (t)	Koncentrat Pb dhe Zn në (t)
Janar	534.00	133.00	692.00	1,359.00
Shkurt	830.00	71.00	779.00	1,680.00
Mars	1,378.00	148.90	840.00	2,366.90
Prill	800.00	85.20	759.00	1,644.20
Maj	740.00	165.24	590.00	1,495.24
Qershor	662.00	128.00	688.00	1,478.00
Korrik	422.00	85.00	770.00	1,277.00
Gusht	569.00	115.00	718.00	1,402.00
Shtator	463.00	114.00	677.00	1,254.00
Tetor	361.00	90.70	534.00	985.70

Nëntor	295.00	70.10	637.00	1,002.10
Dhjetor	250.00	103.00	329.00	682.00
Gjithsejt	7,304.00	1,309.14	8,013.00	16,626.14

Tabel 3. 4. Progresi i të hyrave në raport me planin

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi 2023	Realizimi 2023	Krahasimi i planit me realizim
		(€)	(€)	(%)
1	Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb & Zn	34,358,081.78	16,747,981.89	49%
2	Të hyrat nga shitja e sulfatit të aluminit	300,000.00	213,595.11	71%
3	Të hyrat nga shitja e ujit industrial		9,662.90	
4	Të hyrat nga shitja e rimorkiove	24,576.30		
5	Të hyrat nga shitja e mbetjeve industriale	220,009.00	86,503.62	39%
6	Të hyrat nga qiraja	192,067.44	212,669.86	111%
7	Të hyrat nga shitja e mbeturinave (skrap)	154,000.00	26,881.80	17%
8	Të hyrat nga shitjet e imëta dhe shërbimet	1,860.00	5,647.18	304%
9	Të hyrat nga kompenzimi i shpenzimeve te EE		38,606.16	
10	Të hyrat nga Terminali Doganor	60,000.00	96,845.00	161%
11	Të hyrat nga subvencionet	-	8,397,751.06	
12	Te hyrat nga shpronësimi		1,396,175.42	
13	Të hyrat nga grandet		664,051.00	
14	Të hyrat tjera		150,466.00	
Gjithsejt		35,310,594.52	28,046,837.00	79%

Gjatë vitit 2023, trendi i të hyrave në raport me planin e biznesit nga të gjitha njësitë biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. ka qenë negativ. Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb & Zn në raport me planin e biznesit janë realizuar 49%. Të hyrat nga shitja e sulfatit të aluminit në raport me planin e biznesit janë realizuar 71%. Të hyrat nga shitja e mbetjeve industriale në raport me planin e biznesit janë realizuar 39%. Të hyrat nga qiraja në raport me planin e biznesit janë realizuar 111%. Të hyrat nga shitja e mbeturinave (skrap) në raport me planin e biznesit janë realizuar 17%. Të hyrat nga shitjet e imëta dhe shërbimet në raport me planin e biznesit janë realizuar 304%. Të hyrat nga Terminali Doganor në raport me planin e biznesit janë realizuar 161%. Të hyrat e përgjithëshme të ndërmarrjes Trepça Sh.A. në raport me planin e biznesit janë realizuar 79%.

Tabel 3. 5. Të hyrat e realizuara nga shitja e koncentratit të plumbit dhe zinkut nga tri njësitë prodhuese biznesore; Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg, Miniera me Flotacion Kishnic dhe Artanë dhe Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç

Përshkrimi	ST & KHA	Kopaonik-Leposaviç	Gjithsej të hyrat
	(€)	(€)	(€)
Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb & Zn	7,662,849.89	9,085,132.00	16,747,981.89

4. Përmbledhje e progresit të objektivave kryesore dhe strategjive në ndërmarrjen Trepça Sh.A.

Objektivi kryesor i ndërmarrjes është ta transformojmë Trepça Sh.A. në lider rajonal në prodhimin e koncentrateve të Pb-Zn dhe finalizimin e tyre, duke respektuar normat mjedisore, përkushtimin ndaj profitabilitetit dhe sigurisë së punëtorëve, me qëllim të ngritjes së vlerës ekonomike për aksionarët, investitorët dhe komunitetin.

Synimet e Trepçës janë zbërthyer në një numër objektivash dhe qëllimesh numerike, të cilat duhet t'i arrijnë njësit biznesore të ndërmarrjes. Plani afarist është një mekanizëm që i shërben ndërmarrjes të gjurmë, monitorojë dhe vlerësojë performancën e vet në nivel të njësitve biznesore dhe të përgatisë plane të detajuara veprimi për implementimin e suksesshëm të strategjisë zhvillimore. Viti 2023 ka qenë një nga vitet më të vështira për sa i përket operimit të minierave, vjetërsia e makinave dhe defektet në infrastruktur të minierës kanë rënduar dukshëm afarizimin e ndërmarrjes Trepça Sh.A.

4.1. Ndryshimet e nevojshme të cilat do të ndikojnë në arritjen e objektivave të planit të biznesit

Trepça Sh.A. objektivi kryesor ka rritjen e prodhimit përmes ngritjes së efikasitetit të shfrytëzimit të mineraleve, hulumtimeve të mëtutjeshme të rezervave gjeologjike, modernizimit të minierave, ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe rritjes së numrit të punëtorëve. Përkundër aktiviteteve për përmirësimin e ambientit, për Trepçën Sh.A. mbetet sfida financimi i vazhdueshëm në përmirësimin (zvogëlimin) e ndotjes minimale të ambientit të cilën e rrethon, ku nevojiten përmirësime që do të ulnin në minimum ndotjen e ambientin.

Tregu në të cilin momentalisht Trepça Sh.A. operon është tregu Evropian. Koncentrati i Plumbit dhe Zinkut eksportohet në Evropë, përmes tenderit publik ndërkombëtar, përderisa furnizimi me material shpenzues dhe makinerik realizohet përmes tregut të brendshëm dhe të jashtëm. Fokusi është prodhimi i koncentratit të Plumbit dhe Zinkut me kualitet sa më të lartë, me qëllim të depërtimit të produkteve tona në të gjitha tregjet botërore të metaleve duke krijuar përparësi konkurruese në raport me prodhuesit tjerë të koncentratit të Plumbit dhe Zinkut.

Realizimi i objektivave të Trepça Sh.A. sipas planit të biznesit 2023 ishte drejtpërdrejtë i ndërlidhur me:

- Rritjen e investime kapitale në minerat dhe flotacionet e njësisë biznesore të Trepça Sh.A.;
- Rritjen e eksploatimit të xehës respektivisht të prodhimit të koncentrateve në flotacione;
- Rritjen e kontrollit të kualitetit gjatë flotimit të koncentratit në raport me normativat dhe standardet adekuate;
- Strukturën e moshës së të punësuarve, sidomos në minierë dhe flotacione;
- Aplikimin e teknologjisë informative dhe digjitalizimin e proceseve të punës;
- Aftësimin dhe trajnimet e stafit në fusha përkatëse;
- Mirëmbajtjen dhe modernizimin e kapaciteteve ekzistuese teknike-teknologjike me qëllim të ngritjes së produktivitetit dhe zgjerimit të kapaciteteve prodhuese;
- Rritjen e të hyrave dhe maksimizimin e fitimit në të gjitha njësitë e Trepça Sh.A.

4.2. Rreziqet dhe sfidat e së ardhmes së korporatës

Rreziqet dhe sfidat kryesore me të cilat do të ballafaqohet ndërmarrja Trepça Sh.A gjatë dy viteve të ardhshme janë:

- Gjendja e vazhdueshme e rëndë financiare, borxhet e akumuluar dhe mungesa likuiditetit për kapital punues dhe investime kapitale;
- Humbjet dhe rrjedhjet në procesin industrial si rezultat i pajisjeve të vjetëruara;
- Pamundësia e zinxhirit finalizues teknologjik të përpunimit të xehes;
- Fuqia punëtore e shtyrë në moshë;
- Mungesa e fuqisë punëtore në çdo njësi biznesore;
- Pensionimi i punëtorëve të kualifikuar dhe pamundësia e plotësimit me punëtorë të rinj;
- Pajisjet e vjetërsuara dhe jo kompatible me metodat bashkëkohore;

- Mungesë e strukturave kadrovike, inxhinier të elektros, teknologjisë, përgatitjes së lëndëve minerare (PLM) dhe inxhinier të metalurgjisë;
- Objektet industriale të vjetra, në përgjithësi të amortizuara dhe të vlerësuara si jo efektive për riaktivizim;
- Procedurat përmbartimore për detyrimet e ndërmarrjes, në veçanti çështjet e ngritura në apel;
- Kostoja e lart e kapitali punues;
- Kostoja e lartë e energjisë elektrike;
- Ngritja e çmimeve të furnizimeve me lëndë të parë dhe mjeteve themelore për industrinë e minierave;
- Trendi negativ i rënies së çmimeve të metaleve në bursën ndërkombëtare.

Për uljen e ndikimit të rrezikut veprimet që duhet të ndërmerren nga ndërmarrja Trepça Sh.A., janë:

1. Rritja e eksplotimit të xehes dhe prodhimit të koncentreve të Pb dhe Zn në të gjitha minierat e Trepça Sh.A.;
2. Rritja e prodhimit të Alumin – Sulfatit në Industrinë Kimike dhe prodhimi i produkteve të reja industriale;
3. Një mundësi e mirë e ngritje së buxhetimit për investime kapitale janë valorizimi i Haloiziteve (rreth 3 milion/t) si dhe mbetjeve industriale (rreth 60 milion/t) në ndërmarrjen Trepça;
4. Modernizimi i Flotacioneve me teknologji të avancuar në drejtim të efikasitetit, me objektiv të reduktimit të parametereve të rrjedhjes dhe kostove pasuruese;
5. Sigurimi i pajisjeve dhe makinave të avancuara me produktivite të lart në miniera;
6. Zgjidhja e kontesteve pronëso-ro-juridike dhe financiare nga e kaluara;
7. Integrimi i të gjitha minierave dhe aseteve të ndërmarrjes Trepça Sh.A.;
8. Hartim i legjislacionit për rregullimin e çështjeve sociale, pensionimin e parakohëshëm, stazhin e beneficuar për punëtorët eminerave në ndërmarrjen Trepça Sh.A.;
9. Ngritja e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, krijimi dhe avancimi i kushteve teknike dhe mbrojtëse në punë;

10. Zgjerimi, verifikimi i rezervave të burimeve xehërore në minierat e ndërmarrjes Trepça Sh.A. sipas standardeve të njohura ndërkombëtare.
11. Identifikimi, vlerësimi dhe zhvillimi i resurseve dhe pronave me potencial të zhvillimit ekonomik.
12. Zhvillimi/Ekzaminimi i koncepteve për përdorim dhe shfrytëzim alternativ të pronës (përveç lëndës së parë dhe përpunimit të tij).
13. Respektimi i normave mjedisore nga zhvillimet aktuale komfor legjislacionit në fuqi dhe sanimi i problemeve ekologjike nga e kaluara.

4.3. Investimet kapitale nga BRK

Në kuadër të planit të biznesit për investime kapitale nga buxheti i Republikës së Kosovës për Njësitë Biznesore të ndërmarrës Trepça Sh.A. për vitin 2023 janë realizuar investime kapitale të cilat janë paraparë për këto projekte:

Tabel 4. 1. Investimet kapitale në njësitë biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. nga BRK 2023

Investime kapitale në njësitë biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. nga BKK - 2023		
Nr.	Miniera me flotacion Stantërg	Kontratat e Realizuara (€)
1	Furnizim me pjesë për makinat nëntoksore e ngarkuese ST2D	54,600.01 €
2	Furnizim me pompa, valvula dhe qarqe të pompave për stacionet e pompimit	35,864.00 €
3	Furnizim me pjesë për makinën hulumtuese Diamek	94,862.16 €
4	Furnizim me motorra për makina vetëngarkuese nëntoksore	76,299.00 €
5	Furnizim me burgija shpimi	97,950.62 €
6	Furnizim me material çeliku	17,640.00 €
7	Furnizim me pjesë për pompa 10 x 8 të sterilizimit	62,335.00 €
	Gjithësejt	439,550.79 €
	Miniera me flotacion Kizhnicë dhe Artanë	
1	Pjesë rezervë për makineri produktive (Cavo, Lokomotiva, Lopata ngarkues etj)	47,320.00 €
2	Revitalizimi i mullinjëve te Flotacionit M1 dh M2	25,596.56 €
3	Investime për paisje për minierën e Artanës	119,829.00 €
	Gjithësejt	192,745.56 €
	Miniera e Kopaonikut me flotacion Leposaviq	
1	Makinë transportuese (kamion kipper)	71,390.95 €
	Gjithësejt	71,390.95 €
	Gjithësejt investimet kapitale të realizuara nga njësit biznesore	703,687.30 €
	Investime kapitale të planifikuara nga investimet kapitale	970,000.00 €
	Ndryshimi në vlerë	(266,312.70 €)
	Ndryshimi në (%)	73%

4.4. Investimet kapitale nga buxheti vetanak

Gjatë vitit 2023 përveç investimeve kapitale nga BRK janë realizuar edhe investime kapitale nga burimet vetanake në njësitë biznesore të Trepça Sh.A të cilat janë të shpalosura në tabelën 4.2.

Tabel 4. 2. Investimet kapitale nga buxheti vetanak në Trepça Sh.A.

Investime kapitale në njësitë biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. nga burimet vetanake 2023		
Njësitë Biznesore Minierat e Stantërgut, Minierat e Artanës, Fabrika e Pajimeve të Procesit, Minierat e Kopaonikut, Metalurgjia e Zinkut		Vlera (€)
1	Furnizim me llampa të xehetarëve	25,718.10 €
2	Riparimi i kamionve	9,479.00 €
3	Furnizim me mini eskavator për Minierë	42,498.88 €
4	Furnizim me material për mulli MSR 3600X4000	99,993.20 €
5	Furnizim dhe montim me mbushës dhe bateri stacionare	19,825.96 €
6	Furnizim me kablo elektrike me mbrojtje mekanike	68,440.00 €
7	Riparimi i elektromotorit	1,485.00 €
8	Furnizim me qark punues të pompave	4,485.00 €
9	Furnizim me mjete pune, vegla makinerik	31,857.05 €
10	Furnizim me material elektrik për remont në Minierën me Flotacion Artanë	5,542.00 €
11	Furnizim me litarë çeliku Litar Çeliku 44 mm për minieren e Stantërgut	33,748.00 €
12	Renovimi i zyreve në Minierën e Stantërgut	18,643.59 €
13	Riparimi i kompjuterit të motorrit dhe alternatorit të GIA Lokomotivës	3,960.00 €
14	Riparimi i kompresorve në Minieren e Artanës	5,000.00 €
15	Material për mbulojen e objektit	3,422.00 €
16	Furnizim me kushineta	9,970.00 €
17	Furnizim me thika të ushqyesit për mullirin nr.2	8,496.00 €
18	Furnizim me material çeliku për mbulojë të repartit në FPP	15,315.00 €
19	Furnizim me goma për makinat vetëngarkues Cavo dhe T2GH	19,650.00 €
20	Furnizim me goma të brendshme dhe të jashtme për ngarkues nëntoksor dhe kamiona nëntoksorë	38,704.00 €
21	Servisimi dhe licencimi i vinçit të koncentratit Pb dhe Zn	19,777.98 €
22	Furnizim me pjesë për kamiona nëntoksorë GHH	64,996.23 €
23	Furnizim me vegla pune dhe material makinerik	33,426.03 €
24	Ngjyrosja dhe riparimi i jashtëm i ndërtesës së menaxhmentit	3,250.00 €
25	Furnizim me material elektrik për Flotacion	14,905.76 €
26	Furnizim me pjesë për motora për makinat nëntokësore	44,180.87 €
27	Furnizim me qarqe për pompa në Minierë	15,820.00 €

28	Furnizim me ventilator Aksial	4,000.20 €
29	Furnizim me pajisje testuese për aparate të frymëmarrjes	9,894.30 €
30	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve(veturave)	6,868.30 €
31	Servisimi i kompresorit COMPAIR (L-160 KW)	4,494.82 €
32	Investime në pajisje për qeten e shpëtimit për Minierën e Artanës	119,829.00 €
33	Furnizim me material për mbulojen e kulmit të ndërtesës së NJB Metalurgjia e Zinkut	9,582.00 €
34	Ventilator, Akcial për minierë P=15kw	14,750.00 €
35	Binar, shina çeliku	46,151.79 €
36	Pumpa të ujit, VC 125-200/4	3,562.01 €
37	Kamion kipper (pagesë e pjesëshme nga burimet vetanake)	7,940.45 €
	Gjithësejt	889,662.52 €

ANNEX 1

Çështjet kryesore ligjore të proceduara gjatë vitit 2023 në Trepça Sh.A.

Zyra ligjore ka bërë një përmbledhje të procedurave gjatë vitit 2023.

Zyra Ligjore në kuadër të ushtrimit, përgjegjësi, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore për vitin 2023 është përpjekur të bëjë një punë cilësore duke kryer harmonizimin, plotësim-ndryshimin dhe hartimin e akteve nënligjore që janë propozuar nga menaxhimet dhe organet tjera të Trepça Sh.A. Zyra ligjore përgjatë vitit 2023 është marr me këto aktivitete:

- Ofrimi i këshillave dhe opinioneve ligjore për Kryeshefin dhe organet tjera të ndërmarrjes;
- Përfaqësimi i shoqërisë nëpër gjykata;
- Hartimin dhe harmonizimin e rregulloreve si dhe akteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi, përpilimi i vendimeve, urdhëresave, marrëveshjeve dhe shkresave të ndryshme përcjellëse për Kryeshefin Ekzekutiv dhe organet tjera;
- Arkivimi dhe sistemimi i dokumenteve të zyrës ligjore si dhe përcjellja e vazhdueshme e ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve relevante;
- Zyra Ligjore përgjatë vitit 2023 ka përfunduar po thuajse 95% të të gjitha objektivave të synuara me Planin Vjetor si dhe fal punës së pa lodhshme me plot aktivitet dhe veprime juridike Trepçës Sh.A i janë kompensuar mjete kështu duke ndihmuar Zyra Ligjore në arkëtimin e mjeteve monetare krejt kjo përmes propozimeve për përmbarrim, pranimit të

prapësimeve nga ana e gjykatave, përfaqësimit e drejt në gjykata e shumë çështje tjera të cilat janë të specifikuar më poshtë.

Padi me propozim për masë të sigurisë				
Nr	Nr.lëndës	Data e paraqitjes	Data e seances	Data e marrjes së vendimit i shkallës së I dhe rezultati
1	EK.nr.789/21	06.12.2021	14.01.2022	18.01.2022, Refuzim i masës së sigurisë (në favor të Trepçës)
2	KP.nr.154/22	17.10.2022	17.01.2023	Refuzim i masës së sigurisë
3	KE.nr.2363/22	11.11.2022	11.01.2023	Pajtim gjyqësor (2,250.00€)

Padi nga ana e Trepçës për lirimin e pronës dhe fitmit të humbur				
Nr.	Nr. i lëndës	Paditësi	Data e paraqitjes	Data e marrjes së vendimit i shkallës së I dhe rezultati
1	Nr.prot. 5905	Trepça Sh.A	23.12.2021	Në proces
2	Nr.prot. 6998	Trepça Sh.A	21.12.2022	Në proces
3	Nr.prot. 5733	Trepça Sh.A	15.12.2021	Në proces
4	Nr.prot. 5731	Trepça Sh.A	15.12.2021	Në proces

Padi nga ana e Trepçës për kompensim dëmi të shkaktuara me vepër penale (vjedhje)				
Nr.	Nr. Prot. i lëndës	Paditësi	Data e paraqitjes	Data e marrjes së vendimit në shkallë I dhe rezultati
1	1451 / 28.03.2022	Trepça Sh.A	28.03.2022	Në proces

Dërgim i kërkesave për lirimin e pronës				
Nr.	Nga	Nr. i lëndës	Lënda	Data e paraqitjes
1	Trepça Sh.A	Nr.prot. 6435	Kërkesë për lirim prone	21.11.2022

Kallëzime penale për uzurpim prone					
Nr.	Nga	Nr. i lëndës	Lënda	Data e paraqitjes	Rezultati
1	Trepça Sh.A	Nr.prot. 5819	Kallëzim Penal	24.10.2022	Në proces
2	Trepça Sh.A	Nr.prot. 537	Kallëzim Penal	01.02.2023	Në proces

Kallëzime Penale për shkak të dyshimit për vepër penale				
Nr.	Nga	Nr. i lëndës	Lënda	Rezultati
1	Trepça Sh.A	1964 / 07.04.2023	Kallëzim Penal	Në proces
2	Trepça Sh.A	6622 / 15.11.2023	Kallëzim Penal	Në proces

Propozimet për përmbarim për vitin 2023			
Nr.	Nr. Lëndës	Kreditori	Shuma e ekzekutuar
1	P.nr.231/2023	Trepça Sh.A	€ 5,821.06
2	P.nr.235/2023	Trepça Sh.A	Llogaria e bllokuar
3	P.nr.245/2023	Trepça Sh.A	€ 3,900.00
4	P.nr.232/2023	Trepça Sh.A	€ 1,437.49
5	P.nr.233/2023	Trepça Sh.A	€ 2,317.97
6	P.nr.218/2023	Trepça Sh.A	€ 6,903.00

Arkëtimi i fitimit të humbur		
Nr.	Nr.lëndës	Data e marrjes së vendimit i shkallës së I dhe rezultati
1	KP.nr.154/22	€ 20,000.00
2	KE.nr.2363/22	€ 2,250.00

Lëndët e fituara në gjykatë për kompensim dëmi			
Nr.	Nr.lëndës	E paditura	Vendimi
1	C.nr.1141/2023	Trepça Sh.A	Refuzim i padisë në vlerë prej 154,700.00€
2	C.nr.1608/2023	Trepça Sh.A	Refuzim i padisë

Lëndët e fituara përmes prapësimit		
Nr.	Nr.lëndës	Vendimi
1	KPPP.nr.2500/22	Aprovohet prapësimi në favor të Trepça Sh.A në vlerë prej 998,902.93€
2	KPPP.nr.1657/22	Aprovohet pjesërisht prapësimi në favor të Trepça Sh.A në vlerë prej 120,744.60€
3	KPPP.nr.2012/22	Aprovohet prapësimi në favor të Trepça Sh.A në vlerë prej 52,053.69€